

**PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSBS)
IZVEŠTAJ O SASTANKU OPŠTINSKOG ODBORA ZA BEZBEDNOST ZAJEDNICE (OOBZ)**

Komuna / Opština: Drenas Data / Datum: 16.02.2017

Numri i takimit për këtë vit / Redni broj sastanka u ovoj godini: 1

Takim i rregullt / Redovni sastanak Takim i jashtëzakonshëm / Vanredni sastanak

Numri i anëtarëve të KKSBS-së të pranishëm / Broj prisutnih članova OOBZ: 13

A kanë marrë pjesë në takim përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, nëse janë anëtarë të KKSBS-së? Da li su predstavnici neveçinske zajednice, u svojstvu članova OOBZ, prisustvovali sastanku?

Po / Da
Jo / Ne

Nuk ka anëtarë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë/Nema članove koji predstavljaju neveçinske zajednice

A kanë marrë pjesë anëtarë të tjerë përveç anëtarëve të KKSBS-së?

Da li je neko osim članova OOBZ prisustvovaao sastanku?

Po / Da KFOR, LMT K9, OSCE
Jo / Ne

Nëse "Po", ju lutem potenconi organizatën të cilën e përfaqësojnë
Ukoliko je odgovor "Da", molimo navedite koje organizacije predstavljaju

A është kryesuar takimi nga Kryetari i Komunës apo nënkyetari?

Da li je sastankom predsedavaao Gradonačelnik ili Zamenik?

Po / Da
Jo / Ne

Temat në rendin e ditës / Teme na dnevnom redu:

Në mbledhje u diskutuan këto pika të rendit të ditës:

1. Procesverbal i mbledhjes së kaluar, mbajtur më 27/12/2016,
2. Plani i punës së KKSBS-së, për vitin 2017
3. Informim nga DSHPE lidhur me eliminimin e deponive ilegale,
4. Hartimi i planit Operativ për Reagime Emergjente,
5. Sinjalizimi apo rrëthimi i zonave të eksplatuara,
6. Pengesat në rrugë (shtylla të ndryshme).

Ju lutem, potenconi temat tjera për të cilat është diskutuar në të ndryshmet / Molimo navedite druge teme o kojima se diskutovalo:

Konkluzionet / Zaključci:

1. *Pika e parë e rendit të ditës u miratua unanimisht.*
2. *Pika e dytë* - Plani i punës së KKSBS-së, për vitin 2017 u miratua me ndryshime.
3. *Në pikën e tretë të rendit të ditës* - Drejtoresha e DSHPE-së, znj. Krapi, njoftoi të pranishmit lidhur me eliminimin e deponive ilegale, ku në kuadër të garës për mjedis të pastërt është dhe kriteri për largimin dhe rehabilitimin e deponive ilegale, afati për t'a përmbytjesh këtë kriter është deri më datën 31/03/2017. Krahas largimit të deponive ilegale është obligative të bëhet edhe raportimi pranë MMPh-së. Përveq largimit të deponive është shumë e nevojshme dhe e domosdoshme që të ndërmirren masa për sigurimin e qëndrueshmërisë së projektit. Masat që duhet të ndërmirren janë:
 - Të gjitha institucionet e posaqërisht shkollat të janë në shërbim për menagjim të mbeturinave,
 - Bizneset të hynë në shërbim, si dhe të merret një vendim që të gjitha ekonomitë familjare të hyn në shërbim,
 - Inspektorati dhe policia të janë më aktivë dhe të vëjnë gjobat ndaj atyre që hudhin mbeturina në hapsira publike.
 - Propozohet që të lironen nga pagesa 300 ekonomi familjare me gjendje të rëndë ekonomike, që mbërrinë shumën vjetore **16,920.00 euro**.
4. *Në pikën e katërt* - Hartimi i Planit Operativ për Reagime Emergjente, propozuar nga anëtari i KKSBS-së, z.Arben Nika i cili sqaroj për pikën që propozoi, Komuna e Drenasit e ka një plan të vlerësimit të rrezikut por nuk ka plan komunal për reagime emergjente. Hartimi POE është iniciuar nga ish Kryetari i Komunës dhe DSHPE-ja, por ai ka ngel pa u punuar. Për hartimin e këtij plani duhet të formohet një grup punues dhe të caktohet një koordinator i grupit, i cili mund ta kordinoj grupin. Për hartimin e planit pasi të ngritet grupei punues, mund të kërkohet mbështetje edhe nga AME dhe donator si: UNDP, KCSF, GIZ etj. Pse kemi nevoj për një POE? Përveq rasteve të përgjithshme siq janë fatkeqësítë natyrore dhe shoqërore si: Termetet, Zjarret, Vërshimet, Sulmet e ndryshme etj, në Komunën e Drenasit ka mjaft burime potenciale të rrezikuar për të cilat duhet të ketë edhe POE, si: Fabrika e Feronikelit, Autostrada, Hekurudha-Tunelet, Linja konjektuese e tensionit të lartë etj.
5. *Në pikën e pestë* - Sinjalizimi apo rrëthimi i zonave të eksplatuara, propozuar nga Arben Nika, në Komunën e Drenasit ka disa pika germimi për zhavor natyror, disa gurore, si dhe kemi minjerën (dy minjerat) e Feronikelit si dhe disa germime të ndryshme si në Fushticë etj. Është shumë e rëndësishme po edhe e domosdoshme që këto pika të shënohen me shenja paralajmruese, apo edhe të rrëthohen në tërsi sepse këto zona vazhdimisht paraqesin burimt e rrezikut për njerun por edhe për botën shtazore.

6. Dhe në pikën e gjashtë –Pengesat në rrugë (shtylla të ndryshme), propozuar nga Arben Nika, i cili sqaroi që në rrugët e Drenasit si në shumë rrugë të vendit po paraqesin disa pengesa të cilat ndoshta shumë lehtë mund të evitojen, ndër pengesat më evidente janë: Shtyllat elektrike dhe të operatorëve të ndryshëm kabllor nëpër rrugë dhe trotuare të cilat po e pengojnë qarkullimin e automjeteve por edhe të këmbesorëve e si rezultat mund të vij deri te aksidentet e mundëshme, e në kohë të fundit edhe shtyllat për emërtimin e rrugëve të cilat operatorët e pa përgjegjshëm vetëm po i vendosin pa i llogaritur pengesat dhe rreziqet që mund t'i shkaktojnë. Si pengesa janë:

- Shtyllat elektrike dhe të operatorëve kabllor, shtyllat për emërtimt e rrugëve.
- Rrjeti elektrik dhe kabllor shumë i ulët në rrugë kryesisht në fshatra ku si rezultat ka pasur shumë pengesa për grumbullim të mbeturinave,
- Pengesat në trotuare nga automjetet, parkimi i automjeteve në udhikryqin kyesor të bankat komerciale, dhe te komuna e re, shenjëzimi horizontal tek barnatoret, dhe te statacioni i autobusëve. Vendkalimi i këmbesorëve mbi urën e lumi Drenica deri te shkollat e mesme, etj.

Pjesëmarrësit patën rastin të elaborojnë edhe çështje tjera me Kryetarin e Komunës dhe zyrtarë përgjegjës të Sektoreve.

Procesverbali u përpilua nga koordinatoria e KKSB-së:

Izveštaj pripremio Koordinator OOBZ, Rihore Zymieri
(emri, mbiemri dhe nënshtrimi / ime, prezime i potpis)

Procesverbali aprovohet nga Kryetari:

Izveštaj odobrava Gradonačelnik: Ramiz Lladrovci

nënshtrimi / potpis

Data e aprovimit / Datum odobravjanja: 20.02.2017

Rekomandimet:

- Dërgimi i këtij procesverbali është obligim që del nga UA 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL nen 11 pika 6;
- Prosesverbali përpilohet nga koordinatori i KKSB-së në Komunën përkatëse;
- Prosesverbali duhet të dërgohet në MPB në e-mail adresën: mpb.dsb@rks.gov.net
- Prosesverbali duhet të dërgohet në MAPL në e-mail adresën: Shkrimorja.Mapl@rks.gov.net

Prosesverbalt duhet të dërgohet njëkohësisht me fletën e takimit të ardhshëm të KKSB-së.